



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Çështje Kanitologjike



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Nr./No. 342
Data/Date: 02.06.2022

ZYRA E KRYETARIT

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008), nenin 43 shkronja b) të Statutit të Komunës me Nr. 98 të datës 17.08.2012, nenin 34 pika 12 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, nenin 18 pika 1, 2 dhe paragrafin 2.3 të Rregullores me Nr.16/2020 për Pranim në Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 02.06.2022 bënë këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Ekspert i jashtëm në fushën e përzgjedhjes /vlerësimit të burimeve njerëzore nga organizata të specializuara apo universitete.

Lokacioni / vendi i punës: Komuna e Fushë-Kosovës.

Pagesa fikse është 250 euro, e cila paguhet për secilën procedurë të rekrutimit për ekspertin e angazhuar.

Mandati : dy (2) vjeçar.

Detyrat kyçe:

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i “Komisionit për pranim në shërbimin civil” dhe do të kryej detyrat e tij ashtu siç janë përcaktuar në Rregulloren Nr.16/2020 për Pranim në Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kriteret:

- Diplomë universitare me të paktën 240 kredi - për diplomat e marra jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i tyre.
- Të ketë të paktën katër (4) vjet përvojë pune në pozita të nivelit drejtues.
- Të mos ketë qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit.
- Të ketë integritet moral dhe profesional.
- Të mos ketë qenë i dënuar penalisht për kryerjen e një vepre penale;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

Zyra e Kryetarit

Adresa: Komuna Fushë-Kosovë,
rr. Tahir Zemaj Nr.2 – 12000 Kosovë

Telefon:038/20040503

<http://kk.rks-gov.net/fushekosove>



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

- Kopja e letërnjoftimit;
- CV;
- Kopja e diplomës e noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshmi që nuk është i dënuar penalisht për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Deklaratë se nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Deklaratë se nuk është i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Arkivit në Komunën e Fushë-Kosovës.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 8 (tetë) ditë, nga data 02.06.2022 deri me datën 09.06.2022.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të arritura pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret hyjnë në listën e ngushtë dhe njoftohen përmes tabelës së shpalljeve dhe telefonit.



Zyra e Kryetarit

Adresa: Komuna Fushë-Kosovë,
rr. Tahir Zema Nr.2 – 12000 Kosovë

Telefon:038/20040503

<http://kk.rks-gov.net/fushekosove>